

SEKSIONI I KATËRT
ÇËSHTJA SHERO VOGLI KUNDËR SHQIPËRISË
Ankimi nr. 18343/11

VENDIM

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), e mbledhur në datën 15 tetor si Komitet i përbërë nga:

David Thór Björgvinsson, president

Vincent A. De Gaetano,

Krzysztof Woltyczek, gjykatës,

dhe Françoise Elens-Passos, regjistruer Seksioni,

Duke marrë në konsideratë ankimin e mësipërm të depozituar në datën 7 mars 2011,

Duke marrë në konsideratë deklaratat zyrtare që pranojnë një zgjidhje miqësore të çështjes,

Pas shqyrtimit, të çështjes, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Ankuesja, znj. Shero Vogli është një shtetase shqiptare, e cila ka lindur, në vitin 1955, dhe banuese në Tiranë.

Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga agjenti i saj nga Avokatura e Shtetit, znj. L. Mandia.

Ankuesi u ankua se ka pasur një shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës për shkak të moszbatimit të një vendimi të formës së prerë të dhënë në favor të saj.

Në datat 30 janar dhe 26 shkurt dhe në vitin 2013, Gjykata mori deklaratat për zgjidhjen miqësore të nënshkuara nga palët sipas të cilave ankuesja kishte rënë dakord të hiqte dorë nga pretendime të mëtejshme kundër Shqipërisë në lidhje me faktet mbi të cilat bazohet ankimi kundër një angazhimi nga Qeveria për t'i paguar asaj 7,500 (shtatë mijë e pesëqind euro) për mbulimin e çdo dëmi monetar dhe jomonetar, si dhe për kostot dhe shpenzimet që do të konvertohen në monedhën vendase në normën e zbatueshme në datën e pagesës dhe nuk do t'u nënshtrohen taksave që mund të jenë të zbatueshme. Kjo shumë do të jetë e pagueshme brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të marrë nga Gjykata. Në rast mospagimi brenda periudhës së lartpërmendur tremujore, Qeveria mori përsipër të paguajë interes të thjeshtë për të, nga mbarimi i periudhës deri në shlyerje, në një normë të barabartë me normën e huadhënies marzhinale të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit të interesave plus tri pikë për qind. Paga do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

E DREJTA

Gjykata vëren zgjidhjen miqësore të arritur ndërmjet palëve. Ajo është e bindur se zgjidhja bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut që përcaktohen në Konventë dhe protokollet e saj dhe nuk konstaton asnjë arsye për justifikimin e vazhdimin të shqyrtimit të ankimit. Sa më sipër, është e përshtatshme që çështja të fshihet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata unanimisht

Vendos të fshijë ankimin nga lista e çështjeve në përputhje me nenin 39 të Konventës.

Françoise Elens-Passos	David Thór Björgvinsson
REGJISTRUES	PRESIDENT